


STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TË INSTAT

2017-2030

An abstract graphic at the bottom of the page consists of several overlapping, semi-transparent geometric shapes in shades of blue and grey. The shapes are layered to create a sense of depth and movement, with some appearing to recede into the background while others are in the foreground. The overall effect is modern and architectural.

HYRJE

Me miratimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2017-2021 nga Kuvendi i Shqipërisë (shkurt "Programi"), si dhe në kuadër të rishikimit të kuadrit ligjor për forcimin e rolit të INSTAT si koordinator të Sistemit Kombëtar Statistikor, ka lindur nevoja për hartimin e një dokumenti strategjik i cili do t'i shërbejë institucionit për të:

- përmbushur detyrat e ngarkuara me ligj dhe Program;
- përmirësuar imazhin e institucionit dhe rritjen e besueshmërisë së publikut në statistikat zyrtare;
- përmirësuar cilësinë e të dhënave statistikore dhe gamën e treguesve statistikorë;
- forcimin e bashkëpunimit dhe komunikimit me përdoruesit e statistikave zyrtare.

1. MISIONI, VIZIONI DHE VLERAT

Misioni

Misioni i INSTAT-it është të prodhojë statistika asnjansë, transparente dhe të përditësuara, të cilat ndihmojnë në gjykimin e përdoruesve mbi proceset e zhvillimit e transformimit në fushat ekonomiko-sociale brenda vendit.

Vizioni

INSTAT, si institucioni kryesor prodhues i statistikave zyrtare dhe koordinatori i sistemit kombëtar statistikor, synon të ofrojë të dhëna të besueshme dhe të krahasueshme, duke përshtatur metodologjitë dhe duke shtuar listën e treguesve statistikorë.

Vlerat

Profesionalizmi:

- Besueshmëria
- Objektiviteti
- Bashkëpunimi dhe Komunikimi
- Identifikimi me INSTAT
- Të qënurit i orientuar ndaj përdoruesve
- Të qënurit i orientuar ndaj cilësisë
- Orientimi ndaj zgjidhjeve
- Iniciativa
- Përgjegjshmëria

Integriteti:

- Respekti ndaj njëri tjetrit
- Dinjiteti
- Barazia
- Respektimi i mendimit ndryshe
- Mbështetja ndaj njëri tjetrit

- Shkëmbimi i njohurive

Motivimi:

- Përfshirja në procese
- Fleksibiliteti
- Dhënia e *feedback*
- Qëndrueshmëria

2. SFIDAT

Sfidat kryesore të INSTAT për arritjen e objektivave strategjike dhe zbatimin me sukses të aktiviteteve statistikore në tërësi parashikohet të jenë:

1. Kultura e ndryshimit dhe zhvillimit: INSTAT duhet të përdorë instrumente komunikimi dhe motivimi tek punonjësit në mënyrë që të rritet ndërgjegjja për zhvillim dhe inovacion.

2. Politika dhe strategji efikase: INSTAT duhet të ndërtojë standarde duke aplikuar rregullore, udhëzime, manuale dhe stimuj të tjerë formalë që të drejtojnë institucionin drejt arritjes së objektivave strategjike.

3. Niveli organizativ e institucional: INSTAT duhet të punojë për ndërtimin e sistemeve menaxheriale adekuate, ndërveprimin vertikal dhe horizontal ndërmjet sektorëve për arritjen e qëllimeve afat-shkurtra, afatmesme dhe afat-gjata duke përdorur në mënyrën më të mundshme burimet që disponon institucioni.

4. Komunikimi me përdoruesit. Përdoruesit e statistikave zyrtare janë klientela e produkteve të siguruara nga INSTAT. Institucioni duhet të punojë për t'iu përafuar gjithnjë e më tepër pritshmërisë dhe kënaqësisë së përdoruesve të statistikave zyrtare, duke respektuar në mënyrë rigorozë parimet statistikore dhe standardet ndërkombëtare.

3. ANALIZA SWOT

Analiza SWOT përfshin klimën në të cilën funksionon INSTAT, duke marrë parasysh kuadrin ligjor dhe dokumentar, ambientin dhe kulturën statistikore në të cilin operon, për të vlerësuar kapacitetin, mekanizmat dhe burimet e nevojshme për të garantuar zbatimin e suksesshëm të strategjisë.

FUQITË (Strengths)

- Bazë e konsoliduar ligjore. Duke marrë parasysh eksperiencën e deritanishme dhe raportet e vlerësimit të ekspertëve, kryesisht të Eurostat-it, konstatohet se ligji aktual për statistikave zyrtare është një bazë e fortë ligjore për të garantuar funksionimin normal të INSTAT. Ligji për statistikave zyrtare siguron zbatimin e parimeve themelore të statistikave zyrtare, menaxhimin e burimeve njerëzore dhe financiare dhe besueshmërinë në konfidencialitetin statistikor. Ndërkohë, Programi i ri i Statistikave Zyrtare 2017-2021 miratuar nga Kuvendi, është mekanizmi i duhur zhvillimor pasi specifikon aktivitetet dhe prioritetet statistikore të pesë viteve të ardhshme, për tu përmbushur nga INSTAT dhe agjencitë e tjera statistikore.

- Mbështetja e institucioneve qeveritare, gjë që ka mundësuar forcimin e marrëdhënieve ndërinstitucionale, sigurimin e të dhënave të nevojshme administrative dhe kryerjen në kohë dhe cilësi të aktiviteteve statistikore.
- Eksperiençë profesionale. INSTAT gëzon eksperiençë të konsiderueshme për të garantuar qëndrueshmëri në mbarëvajtjen e aktiviteteve dhe kryerjen me cilësi të tyre.
- Reputacion pozitiv. Duke u mbështetur në aftësitë profesionale të stafit, INSTAT gëzon respektin e përdoruesve gjë që ka sjellë jo vetëm rritjen e numrit të tyre, por edhe rritjen e kërkesave për statistika. INSTAT gëzon reputacion të mirë edhe tek donatorët, të cilët kontribuojnë në zhvillimin e infrastrukturës dhe cilësinë e produkteve statistikore.
- Staf profesional dhe i motivuar. Personeli i INSTAT-it, gëzon kapacitetet profesionale jo vetëm në fushat statistikore, por edhe në ato mbështetëse, si teknologji informacioni dhe administrative. Gjithashtu, pothuajse i gjithë stafi zotëron shumë mirë gjuhën angleze.
- Përputhje dhe zbatim i standardeve statistikore ndërkombëtare. Një pjesë e konsiderueshme e statistikave të INSTAT prodhohen duke respektuar parimet e statistikave, metodologjitë dhe standardet profesionale evropiane.
- Marrëdhënie të mira me institucionet e ngjashme të vendeve të rajonit dhe më gjerë. Në kuadër të proceseve integruese, si dhe duke përfituar nga eksperiencat e ofruara nga Eurostat-i dhe ekspertët e tjerë të huaj, INSTAT dhe agjencitë statistikore kanë arritur të forcojnë marrëdhëniet ndërinstitucionale, si kombëtare ashtu edhe ndërkombëtare.
- Vetëdije për standardet e cilësisë së statistikave zyrtare. Me drejtimin e duhur menaxherial, si dhe duke përfituar nga proceset monitoruese të Eurostat-it, Instituti i Statistikave dhe agjencitë e tjera statistikore janë të ndërgjegjshëm për ngritjen e sistemeve monitoruese dhe përdorimin e instrumenteve të duhura me qëllim rritjen e cilësisë së prodhimit të statistikave zyrtare.

DOBËSITË (Weaknesses)

- Mungesa e formalizimit të marrëdhënieve dhe komunikimit me të gjithë aktorët. INSTAT duhet të angazhohet vazhdimisht për forcimin e bashkëpunimit me institucionet që sigurojnë të dhënat administrative.
- Kuptueshmëria e standardit profesional të statistikave. Përdorimi jokorrekt dhe moskuptimi i të dhënave statistikore të publikuara ndikojnë negativisht në imazhin e institucionit, i cili duhet t'i dedikojë kohë dhe energji përdoruesve për të përmirësuar nivelin e kuptimit në statistikat e prodhuara.
- Infrastrukturë jo e plotë për mbledhjen e të dhënave statistikore. Një pjesë e rëndësishme e informacionit statistikor sigurohet nëpërmjet kryerjes së anketave të ndryshme "derë më derë". Në mënyrë që të reduktohen kostot dhe përmirësohet koherenca e statistikave të prodhuara, INSTAT duhet të fokusohet në prezantimin e mekanizmave moderne të mbledhjes së të dhënave si dhe rritjen e bashkëpunimit me siguresit e këtyre të dhënave. Ndërkohë, në ministritë e linjës apo institucionet e tjera publike mungesa e zyrës së statistikës dhe stafit përkatës sjell mangësi në cilësinë e informacionit statistikor si dhe në sigurimin e këtij informacioni brenda afatit.
- Mungesa e studimeve të thelluara në fushën e statistikës. Në Shqipëri mungojnë fakultetet që diplomojnë statisticienë, duke detyruar INSTAT-in të rekrutojë kandidatë të cilët kanë ndjekur disa lëndë statistikore bazë në shkollat e larta .
- Mungesa e stafit. Për arsye të proceseve të reja të rekrutimit të nëpunësve civilë, duke qendëruar procedurat në Departamentin e Administratës Publike, INSTAT nuk mund të luajë rol aktiv në plotësimin e vendeve vakante sipas strukturës organizative. Kjo ka sjellë vonesë në kryerjen e disa detyrave sipas sektorëve përkatës të institucionit dhe mbingarkesë të stafit të këtyre sektorëve.

MUNDËSITË (Opportunities)

- Mbështetje nga politikbërësit për hartimin e dokumenteve strategjike, politikave makroekonomike dhe sociale si në nivel kombëtar ashtu edhe rajonal.
- Forcimi i marrëdhënieve dhe përmirësimi i komunikimit me institucionet e tjera brenda dhe jashtë vendit.
- Zhvillim i kapacitetit profesional të INSTAT dhe forcim i rolit të tij si koordinator i Sistemit Statistikor Kombëtar.
- Rritje e imazhit të INSTAT përballë publikut.
- Motivim i punonjësve të institucionit për të punuar në një fushë specifike dhe interesante si ajo e statistikave, duke i siguruar promovim dhe karrierë.

KËRCËNIMET (Threats)

Kërcënimet kryesore që INSTAT mund të dështojë në arritjen e objektivave strategjike janë:

- Moskryerja në kohë e detyrave zinxhir të sektorëve gjë që mund të dëmtojë veprimtarinë e sektorëve të tjerë.
- Moszbatimi i detyrimeve që rrjedhin nga Programi i Statistikave Zyrtare nga të gjithë aktorët, si: mosrespektimi i afateve kohore për dërgimin e të dhënave dhe informacioni jo i plotë.
- Mungesa e stafit dhe ndryshimi i strukturës organizative në ministritë e linjës dhe institucionet e tjera që sigurojnë të dhënat administrative;
- Mungesa e burimeve të mjaftueshme financiare dhe kryerja me vonesë e procedurave për prokurimin e mallrave e shërbimeve;

4. KUADRI LIGJOR PËR AKTIVITETET STATISTIKORE

Përcaktimi ligjor i statistikave zyrtare në Shqipëri është parashikuar në Ligjin nr. 9180, datë 05.02.2004 "Për statistikat zyrtare", i ndryshuar. Objekti i këtij ligji është rregullimi i mënyrës së marrjes, organizimit, nxjerrjes dhe shpërndarjes së statistikave zyrtare në Republikën e Shqipërisë. Ligji mbulon këto çështje:

- Parimet e statistikave zyrtare;
- Publikimin dhe shpërndarjen e statistikave zyrtare;
- Programin;
- Rolin, të drejtat dhe detyrat e INSTAT si dhe financimin e tij;
- Rolin dhe detyrat e Drejtorit të Përgjithshëm dhe Këshillit të Statistikave;
- Të drejtat dhe detyrat e agjencive statistikore;
- Konfidencialitetin statistikor

Duke patur parasysh statusin e ri të Shqipërisë si kandidat për anëtarësim në BE, me ndihmën e partnerëve ndërkombëtarë janë dhënë rekomandime për forcimin e kuadrit ligjor në drejtim të krijimit të një sistemi të qëndrueshëm statistikor dhe forcimin e kompetencave të INSTAT si koordinator i këtij sistemi. INSTAT po punon aktualisht për të përmbushur rekomandimet e dhëna duke propozuar ndryshimet e duhura në ligjin bazë të statistikave zyrtare në drejtim të:

- Ndërtimit të një Sistemi Statistikor Kombëtar të qëndrueshëm;
- Forcimin e rolit të INSTAT si koordinator i sistemit;

- Rikompozimit të Këshillit të Statistikave në përbërje të të cilit duhet të jenë përdoruesit e statistikave zyrtare;
- Forcimit të kompetencave të Drejtorit të Përgjithshëm për miratimin e projekt-programeve zhvillimore dhe menaxhimin e INSTAT-it;
- Forcimin e rolit të Drejtorit të Përgjithshëm për të lëshuar udhëzime për tu zbatuar nga agjencitë statistikore për përmirësimin e statistikave zyrtare në vend;
- Rritjen e autonomisë së INSTAT për menaxhimin e burimeve financiare;
- Forcimin e mandatit të INSTAT dhe agjencive statistikore për aksesin në të dhënat administrative;

Memorandumet e mirëkuptimit

Me qëllim që të rritet bashkëpunimi ndërinstitucional dhe gama e të dhënave administrative të nevojshme për prodhimin e statistikave zyrtare, INSTAT ka nënshkruar memorandume mirëkuptimi me institucionet që mund të ofrojnë këto të dhëna. Memorandumet, përveç shprehjes së vullnetit për bashkëpunim ndërmjet palëve, përmbajnë edhe kategoritë e të dhënave që do të transmetohen si dhe mënyrën e transmetimit të tyre. Gjithashtu, memorandumet parashikojnë ngritjen e grupeve teknike të punës, të cilat do të mbulojnë detyrat që kanë lidhje me monitorimin e ecurisë së aktiviteteve të përcaktuara në dokument. Gjithashtu, grupet vënë në dukje problematikat e hasura të cilat pengojnë zbatimin e marrëveshjeve si dhe japin propozimet e duhura për shmangien e pengesave në të ardhmen.

5. OBJEKTIVAT KRYESORË STRATEGJIKE TË INSTITUTIT TË STATISTIKAVE

Sistemi Kombëtar Statistikor, sipas Ligjit të statistikave, është tërësia e institucioneve dhe organizatave që ushtrojnë aktivitet brenda Republikës së Shqipërisë, të cilët mbledhin, përpunojnë dhe publikojnë statistika zyrtare sipas Programit. INSTAT gëzon mandatin ligjor për të qenë udhëheqës i këtij sistemi në interes të zhvillimit të statistikave zyrtare dhe zbatimit të programit pesëvjeçar duke respektuar standardet profesionale ndërkombëtare.

Me ndryshimet që i janë bërë Ligjit të statistikave në vitin 2013, INSTAT ka formalizuar pozicionin e tij si koordinator i Sistemit Kombëtar Statistikor. Për të kryer këtë rol, institucionit i duhet të punojë në drejtim të përmirësimit të imazhit të tij si një institucion i pavarur profesionalisht, i cili synon të sigurojë produkte statistikore transparente, koherente dhe cilësore për përdoruesit. Nga ana tjetër, institucioni duhet të pozicionohet në shkallën më të lartë hierarkike për të siguruar funksionimin e duhur të Sistemit Kombëtar Statistikor, të monitorojë veprimtarinë e aktiviteteve statistikore që mbulojnë institucionet dhe organizatat e përfshira si dhe të japë rekomandimet e duhura për ndjekjen e metodologjive dhe standardeve më të fundit statistikore evropiane.

Duke qenë prodhuesi kryesor i statistikave zyrtare në vend si dhe për të përmbushur rolin e koordinatorit të SKS, institucioni ka nevojë për strategji zhvillimi në vetvete, në terma afatmesme dhe afatgjatë, me qëllim që të garantohen pritshmëritë e cilësisë statistikore në disa plane: imazhin e institucionit, besueshmërinë e publikut në të dhënat që prodhon, përmirësimin e kapaciteteve profesionale dhe rritjen e bashkëpunimit me mbajtësit e të dhënave administrative, përdoruesit e statistikave dhe median.

Në terma afatgjatë, duke patur parasysh vizionin zhvillimor të vendit dhe planet e tjera strategjike kombëtare dhe sektoriale, deri në vitin 2030 INSTAT do të ndërhyjë aktivisht në zhvillimin dhe përmirësimin e disa aspekteve të prodhimit statistikor të cilat do të ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në performancën e institucionit dhe cilësinë e prodhimit statistikor. Objektivat kryesorë strategjikë 2030 të institucionit janë:

Objektivi 1: Prodhimi dhe shpërndarja në kohë e me cilësi e të dhënave statistikore në fushat ekonomike, sociale, të zhvillimit demografik dhe mjedisor në nivel qendror dhe lokal.

Objektivi 2: Përdorimi i burimeve të të dhënave dhe instrumenteve të duhura, për të përmirësuar prodhimin dhe cilësinë e treguesve dhe shërbimeve statistikore.

Objektivi 3: Përmirësimi profesional dhe organizativ i Sistemit Kombëtar Statistikor.

Objektivi 4: Zhvillimi i sistemeve inovative ITC për përpunimin statistikor, shkëmbimin e të dhënave dhe komunikimin.

Me qëllim që të garantohet përmbushja e suksesshme e këtyre objektivave madhore, gjatë periudhës afatmesme 2018-2020, INSTAT do të fokusohet në përmbushjen e një sërë nën-objektivave, përkatësisht:

Objektivi 1

Ky objektivi ndikon drejtpërdrejtë në plotësimin e pritshmërive të përdoruesve për statistika zyrtare për qëllime vendimmarrje, politikbërje, kërkimore-shkencore apo orientuese si dhe në besueshmërinë e publikut në cilësinë e statistikave të prodhuara. Gjithashtu, arritja e këtij objektivi mundëson përmirësimin e imazhit të INSTAT si institucion publik profesional, i cili shërben njëkohësisht edhe si atraksion për statisticienët e rinj të cilët synojnë mundësi karriere në këtë fushë.

Për arritjen e këtij objektivi, deri në vitin 2020 INSTAT do të angazhohet në këto drejtime:

1.1 Prodhimi cilësor i treguesve statistikore kombëtarë dhe rajonalë.

Prodhimi i treguesve statistikor në të dy nivelet është në vetvete veprimtaria kryesore e INSTAT, e përcaktuar në Ligjin nr. 9180, datë 05.02.2004 "Për statistikat zyrtare", i ndryshuar, si dhe Programin 5-vjeçar të statistikave zyrtare.

INSTAT është i detyruar të sigurojë që treguesit statistikore zyrtarë të përfshirë në PSZ 2017- 2021 të jenë në përputhje me parimet statistikore të parashikuara në ligjin "Për statistikat" dhe në përputhje të plotë me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (ESCoP). Gjithashtu, INSTAT është i detyruar t'i prodhojë treguesit statistikore duke respektuar metodologjitë dhe standardet ndërkombëtare.

Një pjesë e rëndësishme e kategorisë së të dhënave janë edhe ato të prodhuara në kuadrin e Objektivave për Zhvillimin e Qëndrueshëm (SDG), të cilat konsistojnë në krijimin e një platforme që synon transformimin e gjithë njerëzimit dhe planetit tonë në një rrugë të qëndrueshme zhvillimi brenda vitit 2030. Treguesit e kësaj kategorie do të sigurohen nga burime të ndryshme informacioni, të cilët prodhojnë apo analizojnë tregues apo informacion mbi këtë qëllim. INSTAT, si institucioni kryesor prodhues, do të luajë rolin kryesor gjatë gjithë këtij procesi.

Për shkak të reformës më të fundit të ndarjes administrative, INSTAT dhe prodhuesit e tjerë statistikorë po përballen gjithashtu me kërkesa gjithnjë e në rritje për statistika rajonale. Gjatë viteve të ardhme institucioni do të fokusohet jo vetëm në përmirësimin e treguesve statistikorë, por edhe në rritjen e numrit të tyre në nivel vendor.

1.2 *Rritja e përdorimit dhe e njohurisë mbi prodhimet statistikore;*

Nënobjektivi synon forcimin e pozicionimit të INSTAT në sistemin statistikor shqiptar duke përfshirë angazhimet e përmirësuara me prodhuesit e tjerë të statistikave zyrtare si dhe me përdoruesit, ci cili është një objektivi i IPA 2013. Për të realizuar këtë objektivi, janë planifikuar disa instrumente:

- Përgatitja e një dokumenti strategjik të shpërndarjes së informacionit;
- Mbështetje për planifikimin strategjik për shpërndarjen dhe komunikimin e statistikave zyrtare (në bazë të objektivave);
- Mbështetje në hartimin e strategjive dhe politikave për trajtimin e mediave dhe ekspertizën e marrëdhënieve me publikun në paraqitjet publike;
- Mbështetje në krijimin e grupeve të rregullta të përdoruesve
- Mbështetje për planifikimin dhe prodhimin e materialeve promovuese
- Mbështetje në hartimin e strategjisë së edukimit statistikor
- Ndryshimi dhe përshtatja e faqes së internetit të INSTAT-it si një mjet kryesor për shpërndarjen e statistikave (përfundon në 20 tetor)
- Propozimi i intranetit INSTAT për komunikim të brendshëm (IPA 2013 dhe Sida)

1.3 *Ndërtimi i një sistemi për menaxhimin dhe kontrollin e cilësisë në SKS.*

Menaxhimi dhe kontrolli i cilësisë në SKS është një ndër nismat më të rëndësishme dhe të ndërlikuara që do të ndërmerren nga INSTAT gjatë viteve në vazhdim. Një SKS i qëndrueshëm dhe eficient kërkon kapacitete dhe aplikimin e instrumenteve të duhura monitoruese të veprimitarisë së tij. Për këtë qëllim, INSTAT ka filluar negociatat me Bankën Botërore për të hartuar strategjinë e zhvillimit të SKS.

Nga ana tjetër, një kontribut domethënës do të japë edhe vlerësimi “Peer Review” që kryen Eurostat për Sistemin Kombëtar Statistikor në vendin tonë, i cili parashikohet të kryhen gjatë tremujorit të dytë të vitit 2018.

Për të siguruar që elementët e kontrollit të cilësisë të plotësojnë standardet e kërkuara, INSTAT ka si objektivi të zhvillojë sistemin e automatizuar për menaxhimin e cilësisë në prodhimin statistikor, sipas modelit *Generic Statistical Business Process Model* (GSBPM). Ky model siguron një strukturë standarde dhe një terminologji të harmonizuar për të ndihmuar prodhuesit statistikorë të

modernizojnë proceset e prodhimit të statistikave si dhe të ndajnë metodat dhe komponentët. Nëpërmjet tij monitorohet cilësia, ndryshimet metodologjike, matja e gabimeve dhe revizionimeve të produkteve statistikore.

INSTAT synon që në të ardhmen të prezantojë këtë mekanizëm edhe tek prodhuesit e tjerë statistikorë.

Gjithashtu, INSTAT do të përdorë edhe instrumentet audituese të cilat do të ofrojnë një pamje të përgjithshme të standardeve të prodhuara, si dhe do të sigurojnë informacion mbi komponentë të ndryshëm të cilat kanë nevojë për përmirësim.

Objektivi 2

Agjencitë statistikore dhe institucionet e tjera publike, për ushtrimin e kompetencave dhe përmbushjen e natyrës së punës që kanë, mbledhin të dhëna të cilat mund të përdoren për qëllime statistikore. Rritja e burimeve të të dhënave administrative ndikon drejtpërdrejtë jo vetëm në koherencën dhe cilësinë e produktit statistikor, por edhe në reduktimin e kostove për sigurimin e këtyre të dhënave. INSTAT do të synojë koordinimin e vazhdueshëm të siguruesve të të dhënave administrative në mënyrë që të përmirësohet cilësia dhe mënyra e transmetimit të tyre tek prodhuesi statistikor.

Në mënyrë që të sigurohet transmetimi cilësor dhe i vazhdueshëm i të dhënave administrative, duke respektuar parimet e konfidencialitetit statistikor, INSTAT do të synojë përmirësimin e infrastrukturës së transmetimit të të dhënave dhe administrimit të tyre.

Për arritjen e këtij objekti, deri në vitin 2020 INSTAT do të angazhohet në këto drejtime:

2.1 *Rritja e përdorimit të të dhënave administrative, regjistrave administrative për qëllime statistikore.*

Statistikat e bazuara në regjistra u japin lexuesve një shpjegim të hollësishëm të parimeve dhe praktikave të kësaj fushe gjithnjë e më popullore në statistika. Për këtë qëllim, INSTAT synon zhvillimin e anketave të bazuara në të dhënat administrative tashmë të disponueshme.

Meqenëse sasi të mëdha të të dhënave të tilla gjenerohen në kuadër të sistemeve të ndryshme administrative, INSTAT do të fokusohet në zgjerimin e mundësive të përdorimit të të dhënave për analizë statistikore duke mundësuar reduktimin e shpenzimeve që nevojiten për grumbullimin e të dhënave.

Ndërthurja e burimeve të ndryshme në përpilimin e treguesve në statistikat zyrtare do përmirësojë cilësinë e këtyre treguesve si në drejtim të mbulimit edhe afateve kohore, duke mundësuar përshtatjen më të mirë me metodologjitë ndërkombëtare. Përshtatja e metodologjive për integrimin e të dhënave nga shumë burime shihet si një mjet kyç për të ardhmen.

2.2 *Përdorimi i sistemeve dhe instrumenteve të IT për mbledhjen e të dhënave.*

Zhvillimi i teknologjisë së informacionit ka ndihmuar në procesin e mbledhjes dhe analizës së të dhënave të vrojtimit. Përdorimi i teknologjisë në mbledhjen e të dhënave ka sjellë zhvillimin e sistemeve inovative për mbledhjen e të dhënave të tilla si CAPI (Mbledhja e të dhënave nëpërmjet kompjuterit), CAWI (Mbledhja e të dhënave online), dhe CATI (Intervistimi me telefon).

INSTAT synon përdorimin e metodave të reja për shkak të përparësive që ofrojnë, si psh: eliminimi i problemeve të rrjedhës logjike të pyetësorit, kontrollet e konsistencës gjatë kohës që zhvillohet/plotësohet intervista, eliminimi i procesit të hedhjes së të dhënave në sistem dhe zvogëlimi i kohës që u duhen të dhënave të vijjnë nga terreni. Kalimi drejt metodave alternative të mbledhjes së të dhënave do të kryhet në mënyrë graduale, duke siguruar që cilësia e produktit statistikor të ruhet.

2.3 *Integrimi i informacionit gjeohapsinor me informacionin statistikor.*

INSTAT për të rritur aksesueshmërinë e statistikave dhe për të forcuar rolin e tij si burimi kryesor statistikor ka vendosur prej vitit 2014 si pjesë të faqes web edhe protalin WebGIS "Atlasi Statistikor i Shqipërisë". Ky aplikacion GIS u zhvillua në kuadër të publikimit të të dhënave të Census 2011 për të vizualizuar informacionin statistikor sipas shpërndarjes gjeografike.

Një mundësi e mirë për të integruar informacioni gjeohapsinor me të dhënat statistikore është censusi i vitit 2021-2022 dhe informacioni statistikor i ardhur nga drejtoritë tematike në INSTAT. Ky informacion statistikor dhe gjeohapsinor do të përmirësojnë ndjeshëm cilësinë e statistikave zyrtare nëpërmjet:

- Përditësimin të vazhdueshëm i planifikuar i informacionit.
- Lidhjes së GIS me treguesit statistikor dhe regjistrat.
- Rritjes së numrit të burimeve të informacionit për përditësimin e GIS.
- Rritjes së përdorimit dhe shpërndarjes së informacionit statistikor gjeohapsinor.

Objektivi 3

Forcimi i SKS është një ndër rekomandimet kryesore të Eurostat për Shqipërinë. Fillimisht INSTAT synon të përgatisë kuadrin e plotë ligjor për funksionimin e këtij sistemi dhe, më tej, përdorimin e instrumenteve formale për rritjen e bashkëpunimit ndërmjet prodhuesve të statistikave zyrtare.

Një institucion i cili gëzon kapacitetet e duhura profesionale dhe monitoruese, garanton cilësi monitoruese dhe orientimin e duhur të institucioneve të tjera prodhuese të statistikave zyrtare. Pavarësisht se ky objektivi shtrihet në terma afatgjatë, INSTAT do të synojë përmirësimin e vazhdueshëm të kapaciteteve profesionale të statistikienëve të SKS, nëpërmjet organizimit të aktiviteteve trajnuese që mbështeten nga buxheti i shtetit ose donatorët.

Për arritjen e këtij objektivi, deri në vitin 2020 INSTAT do të angazhohet në këto drejtime:

3.1 *Krijimi i një ambienti pune motivues dhe zhvillimi i kapacitetit profesional të punonjësve.*

Motivimi i stafit është element shumë i rëndësishëm jo vetëm për rritjen e imazhit të institucionit dhe cilësisë së produkteve të tij, por edhe sepse ndikon drejtpërdrejt në qëndrueshmërinë e statistikienëve dhe pengon rrjedhjen.

Me qëllim që të arrihet motivimi i duhur, INSTAT do të përqendrohet në disa drejtime:

- Përfshirja e stafit të të gjitha niveleve në proceset strategjike dhe vendimmarrëse të institucionit;

- Mundësia për pjesëmarrje në *workshop*-e, takime, përgatitjen e paper-ave, etj.;
- Promovimin e kulturës së mësimin të vazhdueshëm dhe zhvillimit profesional për tu siguruar që punonjësit performojnë duke dhënë potencialin e plotë të tyre;
- Shpërblimin e stafit të raste të përfshirjes në aktivitete që janë përtej punës së përditshme;
- Përmirësimi i kushteve të punës dhe përdorimi i instrumenteve moderne gjatë proceseve të punës.

Në vitin 2017, INSTAT ka përgatitur strategjinë e trajnimit për zhvillimin e kapaciteteve profesionale të stafit si dhe zgjerimin e njohurive statistikore tek statisticienët e agjencive të tjera statistikore. Gjithashtu, me mbështetjen e projektit Sida, në periudhën afatshkurtër pranë INSTAT do të behet e mundur ngritja e qendrës së trajnimit, infrastrukturë e domosdoshme për zhvillimin profesional të stafit të SKS, përdoruesve, medias dhe botës akademike.

Në vijim, po me mbështetjen e qeverisë suedeze, INSTAT është përqendruar në krijimin e një sistemi elektronik ndihmës për menaxhimin e burimeve njerëzore, sistem i cili do të mundësojë jo vetëm mbajtjen e rekordeve për secilin punonjës, por edhe pasqyrimin e indikatorëve të performancës dhe eficiencës në kryerjen e detyrave e përgjegjësi.

3.2 *Bashkëpunimi dhe partneriteti me institucionet brenda sistemit kombëtar statistikor dhe prodhuesit e të dhënave.*

Qëndrueshmëria e SKS varet ngushtësisht nga cilësia e komunikimit dhe bashkëpunimit ndërmjet institucioneve që përfshihen në aktivitetet statistikore. Gjatë viteve në vazhdim INSTAT do të synojë jo vetëm të rrisë bashkëpunimin ndërmjet agjencive statistikore në drejtim të unifikimit të metodologjive, përdorimit të standardeve dhe transmetimit të të dhënave, por edhe ndërmjet institucioneve që mbledhin të dhëna për qëllime ose jo statistikore.

Baza e re ligjore do të injektojë në institucionet siguruese të të dhënave detyrimin për të njoftuar INSTAT mbi çdo krijim të ri të të dhënave administrative apo rishikim të tyre si dhe për të bashkëpunuar me institucionet prodhuese të statistikave zyrtare për të gjetur rrugët efiçente për sigurimin e këtyre të dhënave.

Për këtë qëllim, INSTAT do të propozojë vazhdimisht projekt-memorandume mirëkuptimi dy- ose shumëpalëshe për sigurimin e të dhënave në kohë dhe formën e duhur.

3.3 *Fuqizimi i rolit të INSTAT si një pjesëtar aktiv në sistemin statistikor në vend, në rajon dhe në arenën ndërkombëtare.*

Për të ndërtuar një SKS të qëndrueshëm, në gjendje të aplikojë standardet moderne ndërkombëtare, INSTAT synon të intensifikojë marrëdhëniet jo vetëm me institucionet e ngjashme të vendeve anëtare të BE-së dhe Kombeve të Bashkuara, por edhe me organizatat ndërkombëtare në të cilat aderojnë. Duke u bërë pjesë e këtyre organizatave si dhe duke luajtur rol aktiv në përmbushjen e misionit që ata kanë, INSTAT-it do t'i mundësohet të jetë i përditësuar me metodologjitë dhe praktikat më të mira statistikore të aplikuara.

Marrëdhënia ndërinstitucionale me institucionet e ngjashme të vendeve të tjera është mekanizëm i domosdoshëm për të ruajtur koherencën dhe mundësuar aplikimin e standardeve më të fundit të

prodhimit statistikor si dhe për të përfituar nga eksperiencat e institucioneve respektive duke shmangur pengesat e hasura dhe zgjidhur problematikat. Për këtë qëllim, duke gjetur vullnetin ndërmjet palëve, INSTAT ka për objektiv nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet e ngjashme të vendeve të tjera të rajonit dhe më gjerë.

Instituti i Statistikave zë gjithashtu një rol kyç në procesin integruar për shkak të përballjes së kërkesave gjithnjë e në rritje për indikatorë statistikorë në fusha të ndryshme. Për rrjedhojë, INSTAT është pjesë e Grupeve Ndërinstitucionale të Punës për integrimin evropian në pjesën më të madhe të kapitujve të Acquis, ndërkohë që është përgjegjës koordinator për Kapitullin 18 "Statistikat". Në këtë aspekt, roli i INSTAT bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm për vazhën e çeljes së negociatave për anëtarësim në BE.

3.4 *Forcimi i bashkëpunimit me botën akademike për zhvillimin e metodave të reja statistikore, produkteve dhe shërbimeve.*

Nën-objektivi ka për qëllim forcimin dhe intensifikimin e bashkëpunimit me botën akademike në fushën e statistikave në funksion të përmirësimit të sistemit statistikor, kërkimit shkencor dhe rritjes së kapaciteteve profesionale statistikore.

Forcimi i bashkëpunimit me universitetet synon përmirësimin e sistemit statistikor në Shqipëri nëpërmjet përfshirjes së botës akademike në zhvillimin e metodologjive të reja, transmetimit të dijeve mbi statistikën, dhe pasurimit të përmbajtjes së programeve të studimit me koncepte dhe analiza të hartimit, zbatimit e monitorimit të sistemit statistikor në Shqipëri. INSTAT do të orientohet drejt një përfshirje më të madhe të akademikëve për implementimin e metodologjive dhe teknikave inovative të cilat do të kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së zinxhirit të prodhimit statistikor dhe kërkimit shkencor.

Gjithashtu, duke bashkëpunuar me botën akademike, INSTAT kërkon të jetë promotor i kërkimit shkencor në Shqipëri. Në këtë kuadër synohet zgjerimi i bashkëpunimit me universitetet dhe qendrat e kërkimit shkencor në fushën e statistikave, duke organizuar dhe marrë pjesë në evente të përbashkëta si konferenca, *workshop*-e, punë kërkimore etj. INSTAT do të krijojë hapësira për vënien në dispozicion të kërkuesve, profesoratit dhe studentëve, materiale të ndryshme metodologjike dhe të dhëna duke respektuar parimin e konfidencialitetit dhe politikave të aksesit mbi të dhënat mikro në INSTAT.

Objektivi 4

Rritja e kërkesës për të dhëna statistikore në kombinim me burimet financiare dhe njerëzore të kufizuara kërkon një modernizim të vazhdueshëm të sistemeve të Teknologjisë së Informacionit, i cili mundëson që të dhënat të prodhohen në mënyrë efikase dhe të integruar. Për të siguruar një organizim efikas dhe një ambient pune modern nevojitet infrastrukturë, procese dhe mjete të përshtatshme të Teknologjisë së Informacionit. Për të mbështetur dhe monitoruar modernizimin e proceseve prodhuese, INSTAT duhet të kryejë një sërë procesesh vlerësimi të *hardware* dhe *software*. Në përputhje me Kodin e Praktikës, prioritet i lartë duhet t'i jepet sigurisë së Informacionit. Gjithashtu projektet e TI-së me rëndësi të veçantë strategjike duhet të vlerësohen në lidhje me menaxhimin e njohurive, reziqeve dhe raportin e kosto-përfitimit.

Automatizimi i proceseve statistikore është një nevojë e domosdoshme për të kapur ritmin me të cilin po zhvillohet sot prodhimi i statistikave evropiane. INSTAT do të vazhdojë angazhimin e tij në lidhje me modernizimin e mbledhjes së të dhënave dhe proceseve prodhuese të statistikave. Për të optimizuar proceset prodhuese duhet që secila hallkë e procesit të analizohej dhe vlerësohet. Zhvillimi dhe përdorimi i një sistemi qendror të integruar të Teknologjisë së Informacionit për menaxhimin e të dhënave dhe metadata-ve, që do të mundësojë punën sinergjike, do të jetë një sfidë për INSTAT në vitet në vijim. Për të siguruar që elementet e proceseve prodhuese të përmbushin standardet e kërkuara të cilësisë, INSTAT duhet të përqendrohet në zhvillimin e sistemeve për menaxhimin e cilësisë, veçanërisht duke u fokusuar në auditimet e brendshme të cilësisë dhe metodologjinë e përdorur për matjen e indikatorëve.

Për arritjen e këtij objekti, deri në vitin 2020 INSTAT do të angazhohet në këto drejtime:

- 4.1 *Automatizimi dhe standardizimi i proceseve të prodhimit statistikor dhe përpunimit të të dhënave.*
Ngritja e një mjedisi standard prodhimi, ku mjetet e teknologjisë së informacionit të kombinohen për të krijuar një mbështetje të integruar për prodhimin e statistikave, nga mbledhja e të dhënave përmes procesit dhe analizës deri tek shpërndarja dhe komunikimi, është thelbësor për optimizimin e punës në INSTAT. Mjedisi i integruar i prodhimit statistikor mundëson mirëmbajtjen efiçente të mjeteve/komponenteve të Teknologjisë së Informacionit dhe aktiviteteve që lidhen me procesin e prodhimit në INSTAT.
- 4.2 *Zhvillimi i sistemeve të informacionit dhe web-services për të ulur response burden, rritjen e cilësisë statistikore dhe përmirësimin e metodave të shpërndarjes.*
Implementimi i teknologjive të reja u mundëson përdoruesve qasjen në të dhëna në një mënyrë të thjeshtë dhe me kosto sa më të ulët, duke u kujdesur dhe për ruajtjen e konfidencialitetit statistikor. Një nga qëllimet strategjike më të rëndësishme të INSTAT është zvogëlimi i ngarkesës së të intervistuarve dhe të vetë sistemit statistikor kombëtar me anë të modernizimit të plotë të tij me qëllim përmirësimin e efiçasitetit dhe cilësisë së produkteve statistikore. Kjo gjë arrihet duke zëvendësuar metodat klasike të mbledhjes së të dhënave statistikore me mbledhjen e të dhënave me anë të metodave inovative CAPI/CATI/CAWI dhe/ose përpunimin e të dhënave nga burimet administrative në vend të kryerjes së anketave statistikore.

6. PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË SË ZHVILLIMIT TË INSTAT

Me qëllim që të sigurohet zbatimi i duhur i nën-objektivave për secilin objektiv strategjik afatgjatë, ky dokument strategjik do të pasohet nga Plani i Veprimit të INSTAT. Plani i Veprimit do të pasqyrojë të gjitha aktivitetet që duhet të përmbushen nga njësitë organizative të INSTAT-it, personat përgjegjës dhe afatet e përmbushjes së këtyre aktiviteteve. Njësitë e ngarkuara për monitorimin e Planit të Veprimit do të marrin inpute në formën e raporteve mujore nga personat përgjegjës mbi progresin e arritur deri në momentin e raportimit për secilin aktivitet.